

VENDIM
Nr. 564, datë 29.9.2018

PËR DHURIMIN UNESCO-s TË IKONËS “NGJALLJA E LLAZARIT”, NË KUADËR TË 60-VJETORIT TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË KËTË ORGANIZATË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhurimin UNESCO-s të ikonës “Ngjallja e Llazarit”, në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë, me të dhënat sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Dhurimi i ikonës “Ngjallja e Llazarit” UNESCO-s të bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe sigurimin e kushteve për ruajtjen e këtij objekti muzeor gjatë transportimit të tij brenda dhe jashtë vendit.

3. Ngarkohet Ministria e Kulturës për lidhjen e kontratës së dhurimit.

4. Ngarkohet Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkelologjik, Korçë, të kryejë procedurat për shoqërimin e ikonës “Ngjallja e Llazarit” deri në dorëzimin e saj tek UNESCO-ja.

5. Ngarkohet Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e veprimit të dhurimit të ikonës dhe monitorimin deri në tjetërsimin e pronësisë së veprës.

6. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E IKONËS “NGJALLJA E LLAZARIT”

IKONA PËR DHURIM						
MUZEU KOMBËTAR I ARTIT MESJETAR, ARSIMIT DHE ARKEOLOGJIK, KORÇË						
Nr. rend.	EMËRTIMI	AUTORI	NR. INV.	KODI QKIPK	PERIUDHA	FOTO
1	NGJALLJA E LLAZARIT	KOSTANDIN DHE ATHANAS ZOGRAFI	2181	28337	Shek. XVIII	